



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 07.12.2022

Nr: 04

Ora: 11:00

UDHËZIM

PËR

**MËNYRËN E KOMUNIKIMIT TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE ME BASHKITË NË
KUADËR TË BASHKËRENDIMIT TË INFORMACIONIT PËR ZGJEDHJET**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” dhe 2, dhe 52, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 01, datë 05.12.2020, të Komisionit Rregullator, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

UDHËZON:

1. Jo më vonë se 3 (tre) ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë cakton një prej nëpunësve të bashkisë si personin përgjegjës për komunikimin me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nga këtu e në vijim në këtë udhëzim referuar si “Personi përgjegjës”. Në rastin e zgjedhjeve të pjesshme/parakohshme caktimi i personit përgjegjës bëhet brenda 24 (njëzetë e katër) orëve nga data e dekretimit të datës së zgjedhjeve. Për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, kryetari i bashkisë cakton personin përgjegjës jo më vonë se 3 (tre) ditë nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.
2. Kryetari i bashkisë i dërgon KQZ-së menjëherë të dhënat mbi personin përgjegjës. Këto të dhëna përmbajnë emrin, mbiemrin, funksionin, adresën e postës elektronike (e-mail), numrin e telefonit fiks dhe numrin e telefonit celular. Të dhënat dërgohen me shkresë në KQZ, si dhe në postën elektronike të këtij institucioni vendore@kqz.gov.al

Data: 07.12.2022 Nr: 04
Ora: 11:00



“Për mënyrën e komunikimit të KQZ me bashkitë, në kuadër të bashkërendimit të informacionit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

3. Personi përgjegjëse dërgon në KQZ informacion për:
- a) procesin e publikimit të listës së zgjedhësve dhe të ndarjes së qendrave të votimit;
 - b) ecurinë e procesit të vendosjes së adresave të qendrave të votimit (QV);
 - c) hartën e zonave të qendrave të votimit;
 - d) vendndodhjen e selive të komisioneve të zonave të administrimit zgjedhor (KZAZ);
 - e) vendndodhjen e mjediseve për zhvillimin e trajnimeve;
 - f) vendosjen e qendrave të votimit në objekte private;
 - g) ngritjen e QV-ve të posaçme;
 - h) ecurinë e procesit të njoftimit me shkrim të zgjedhësve;
 - i) informimin e përditësuar lidhur me numrin e personave me aftësi të kufizuara dhe personave të verbër, si dhe qendrat e votimit të tyre, në funksion të përshtatjes dhe pajisjes së këtyre të fundit me rampa apo maskën *breil*;
 - j) informimin e përditësuar lidhur me numrin e personave që i përkasin pakicave kombëtare si dhe qendrat e votimit të tyre, në funksion të fushatës së informimit dhe sensibilizimit të ndërmarrë nga KQZ-ja;
 - k) çdo informacion tjetër që lidhet me mirëadministrimin e të gjitha fazave të procesit zgjedhor.
4. Personi përgjegjës informon në mënyrë të posaçme KQZ-në, në lidhje me plotësimin e kushteve për të lehtësuar hyrjen në objektet zgjedhore të personave me aftësi të kufizuara.
5. Personi përgjegjës plotëson në kohë reale formularët elektronikë të dërguara nga KQZ-ja, sipas udhëzimeve dhe/ose kërkesave të kësaj të fundit.
6. Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve komunikon me personin përgjegjës nëpërmjet postës elektronike nga adresa vendore@kqz.gov.al dhe/ose përmes platformave të tjera të komunikimit elektronik.
7. Personi përgjegjës komunikon në mënyrë të vazhdueshëm me KQZ-në dhe mban përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë.
8. Struktura përgjegjëse në KQZ për marrjen dhe administrimin e informacionit sipas këtij udhëzimi, i përpunon dhe i administron këto informacione edhe në mënyrë elektronike, të tillë që të mundet të lejojë prodhimin e raporteve informative të ndryshëm, kur është rasti. Të dhënat dhe informacionet e marra sipas këtij udhëzimi janë të hapura për publikun pa asnjë kufizim.

9. Sipas rastit, administrata e KQZ-së i propozon Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, marrjen e masave administrative sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor.
10. Ngarkohen kryetarët e bashkive, personat përgjegjës të caktuar nga ata, si dhe administrata e KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
11. Ky udhëzim i njoftohet bashkive menjëherë nga hyrja e tij në fuqi.
12. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
13. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI